

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve I. K. dhe A. K. që të dy nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.949/2015, të datës 11.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 20.09.2016, në prezencën e Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarve, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

**1. I. K.**, nga i ati H., e ëma H., e gjinisë P., i lindur me datën ... në Prizren, tani me banim në Gjakovë, i martuar, babai i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendje së dobët ekonomike, ashkali- shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. A. K.**, nga i ati H., e ëma H., e gjinisë P., i lindur me datën... në Prizren, tani me banim në Gjakovë, i pa martuar, i pa punë, i pa shkolluar, i gjendje së dobët ekonomike, ashkali- shtetas i Republikës së Kosovës.

### J A N Ë F A J T O R

#### I akuzuari I. K.

**I.** Sepse me datën 25.07.2015, rreth orës 11:00 në rrugën “Ali Ibra” në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të menjëhershme mes të dëmtuarit A. H. dhe të akuzuarit I. K., i njëjti së bashku me vëllain e tij A. K. ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit A. dhe me një mjet të punës-lopate e sulmon të dëmtuarin A. duke e goditur në kokë dhe nëpër trup, me çka i shkakton lëndime të lehta trupore gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e datës 18.09.2015.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së .

#### I akuzuari A. K.

**II.** Sepse në kohë, datë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi i akuzuari e godet me një shkop bejsbolli në kokë dhe nëpër trupë të dëmtuarin A. H. duke i shkaktoar kështu lëndime të lehta trupore të konstatuara nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e datës 18.09.2015.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së .

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe neneve 188 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, të akuzuarve iu shqipton:

## **D Ë N I M I N M E K U S H T**

**1. Të akuzuarin I. K.:** Për veprën penale nën. I të dispozitivit duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

**2. Të akuzuarin A. K.:** Për veprën penale nën. II të dispozitivit duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari A. H. nga Gjakova, me banim në rrugën “...” nr..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohen të akuzuarit I. K. dhe A. K., që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko ligjore në mënyrë solidare shumën prej nga 20(njzet) Euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 20(njzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 949/2015, të datës 11.01.2016, kundër të akuzuarve I. K. dhe A. K. që të dy nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.4 dhe nenin 31të KPRK-së. Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj gjatë seancës së shqyrtimit fillestar para leximit të aktakuzës ka deklaruar se e bëjë përmirësimin e aktakuzës, tek kualifikimet e veprave penale ashtu që ku është shënuar dhe neni 31 të KPRK-së e që në fakte nga dispozitivi i aktakuzës del se nuk kemi të bëjmë me vepër në bashkëkryerje andaj në të dy pikat e aktakuzës për të akuzuarit I. K. dhe A. K. tek kualifikimi e hiqet nenin 31 i KPRK-së, ashtu që vepra penale për të cilën akuzohen secili veç e veç është lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën pika 1.4 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar. Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve I. K. dhe A. K.. Andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari I. K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës dhe ka shtuar se me të dëmtuarin jam pajtuar, nuk kam asgjë të keqe, se është penduar për rastin e ndodhur dhe i premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

I akuzuari A. K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës dhe ka shtuar se me të dëmtuarin jam pajtuar, nuk kam asgjë të keqe, se është penduar për rastin e ndodhur dhe i premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, duke dhënë mendimin rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarve, ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasi që të njëjtit kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë e kanë bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë dhe se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat të cilat mbështet aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike:

**I.** Në tërësi u vërtetua se i akuzuari I. K. me datën 25.07.2015, rreth orës 11:00 në rrugën “Ali Ibra” në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të menjëhershme mes të dëmtuarit A. H. dhe të akuzuarit I. K., i njëjti së bashku me vëllain e tij A. K. ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit A. dhe me një mjet të punës-lopatë e sulmon të dëmtuarin A. duke e goditur në kokë dhe nëpër trup, me çka i shkakton lëndime të lehta trupore gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e datës 18.09.2015.

**II.** Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. K. në kohë, datë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi i akuzuari e godet me një shkop bejsbolli në kokë dhe nëpër trup të dëmtuarin A. H. duke i shkaktoar kështu lëndime të lehta trupore të konstatuara nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e datës 18.09.2015.

Gjykata gjendjet e këtyra faktike i ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve, formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, prandaj dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitive të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: për të akuzuarin I. K. gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese se është babai i 1 fëmije, mbajtës i familjes 4 anëtarësh, i gjendjes së dobët ekonomike, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa për të akuzuarin A. K. si rrethana lehtësuese, gjykata ka vlerësuar se: është i pa punë, i gjendje së dobët ekonomike, jeton me 4 anëtarë të familjes, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, më parë nuk ka qenë i dënuar ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të dy të akuzuarit gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar secilit veç e veç dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas

bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1. të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.18/16, me datë 20.09.2016**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.